



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MIRËMBAJTJES SË OBJEKTEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____._____.2026

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE TË VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

Objekti i procedurës: “Mirëmbajtje e zakonshme e objekteve të arsimit bazë”

Kodi CPV: 50000000-5 – Shërbime riparimi dhe mirëmbajtjeje.

Lloji i kontratës: Shërbime.

Lloji i procedurës së prokurimit: Procedurë e hapur.

Fondi limit: 13 364 107,73 (trembëdhjetë milionë e treqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e njëqind e shtatë presje shtatëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: Buxheti i Bashkisë Shkodër për vitin 2026, miratuar me VKB-në nr. 84, datë 18.12.2025, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2026–2028 të Bashkisë Shkodër”. Fondet janë planifikuar në llogarinë ekonomike 602.

Në mbështetje të nenit 21, pika 2, nenit 41, nenit 42 dhe nenit 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 2, pika 2, shkronja “c”, dhe nenit 78, pika 2, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Autoriteti Kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike, Bashkia Shkodër, harton këtë procesverbal për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe të kriterëve të veçanta të kualifikimit për procedurën e prokurimit me objekt “Mirëmbajtje e zakonshme e objekteve të arsimit bazë”.

Procedura e hapur është përzgjedhur duke marrë në konsideratë llojin e kontratës dhe vlerën e fondit limit. Fondi limit prej 13 364 107,73 lekësh pa TVSH ndodhet ndërmjet kufirit të ulët dhe kufirit të lartë monetar të përcaktuar për kontratat e shërbimeve. Zbatimi i procedurës së hapur mundëson pjesëmarrjen e çdo operatori ekonomik të interesuar që përmbush kriteret e kualifikimit dhe garanton respektimin e parimeve të konkurrencës, transparencës, trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit dhe proporcionalitetit.

Klasifikimi i kontratës si “Shërbime” është bërë duke marrë në konsideratë qëllimin dhe rezultatin kryesor të saj, natyrën e ndërhyrjeve të parashikuara, mënyrën e realizimit dhe burimin e financimit.

Qëllimi kryesor i kontratës është mirëmbajtja e zakonshme e objekteve ekzistuese të arsimit bazë, me synim ruajtjen ose rikthimin e gjendjes së tyre funksionale, teknike dhe të sigurisë, si dhe sigurimin e kushteve normale për përdorimin e tyre. Kontrata nuk synon ndërtimin e objekteve të reja, zgjerimin e objekteve ekzistuese, shtimin e kapacitetit të tyre, krijimin e një aktivi të ri ose ndryshimin thelbësor të strukturës apo destinacionit të objekteve ku do të kryhen ndërhyrjet.

Preventivi përfshin një tërësi ndërhyrjesh mirëmbajtjeje dhe riparimi, ndër të tjera: prishje të pjesshme dhe pastrime; riparime të suvatimeve, shtresave dhe rifiniturave; bojatisje; riparim ose zëvendësim të dyerve dhe dritareve; ndërhyrje në instalimet elektrike dhe hidrosanitare; riparime të çatave; ndërhyrje në elemente metalike; riparime të dysHEMEVE dhe sipërfaqeve të shtruara; si

dhe procese ndihmëse gjurmimi, betoni dhe armature, të nevojshme për realizimin e ndërhyrjeve përkatëse.

Proceset ndërtimore, elektrike, hidrosanitare dhe mekanike të përfshira në preventiv nuk përbëjnë një qëllim të pavarur të kontratës, por janë procese teknike nëpërmjet të cilave realizohet shërbimi i mirëmbajtjes. Ato lidhen me riparimin, zëvendësimin, riaftësimin dhe ruajtjen e elementeve të objekteve ekzistuese dhe, për këtë arsye, nuk ndryshojnë qëllimin dhe rezultatin kryesor të kontratës.

Edhe proceset që përfshijnë gjurmime, beton, armaturë dhe konstruksione metalike kanë karakter ndihmës dhe plotësues në raport me objektin kryesor të kontratës. Ato shërbejnë për realizimin e ndërhyrjeve konkrete të mirëmbajtjes të parashikuara në preventiv dhe nuk sjellin krijimin e një veprë të re ndërtimore ose ndryshimin thelbësor të objekteve ekzistuese.

Natyra e kontratës konfirmohet edhe nga grafiku katërmujor i realizimit, i cili parashikon zhvillimin e koordinuar të punimeve të prishjes, gipsit, dyerve dhe dritareve, instalimeve elektrike dhe të ndriçimit, suvatimit dhe shtresave, instalimeve hidraulike, betonit dhe hekurit të betonit, shtrimit, bojatisjes, konstruksioneve metalike, çative dhe muraturës. Këto procese përbëjnë së bashku një tërësi ndërhyrjesh për mirëmbajtjen dhe rikthimin e funksionalitetit të objekteve arsimore ekzistuese.

Fondet për realizimin e kontratës janë planifikuar në llogarinë ekonomike 602, si shpenzime operative për mirëmbajtjen e zakonshme të objekteve publike. Ky klasifikim buxhetor është në përputhje me qëllimin dhe rezultatin kryesor të kontratës.

Për sa më sipër, kontrata klasifikohet si kontratë shërbimi, ndërsa proceset fizike dhe teknike të përfshira në preventiv konsiderohen pjesë përbërëse dhe instrumentale të shërbimit të mirëmbajtjes.

Specifikimet teknike dhe kriteret e veçanta të kualifikimit janë hartuar mbi bazën e kërkesave të njësisë kërkuese, preventivit, specifikimeve teknike, termave të referencës, grafikut të realizimit të shërbimeve, fondit limit të miratuar dhe analizës së natyrës së ndërhyrjeve që përfshin objekti i prokurimit.

Kriteret janë përcaktuar me qëllim përzgjedhjen e një operatori ekonomik që disponon kapacitetet profesionale, ekonomike, financiare, teknike dhe njerëzore të nevojshme për realizimin me sukses të kontratës. Çdo kriter duhet të lidhet drejtpërdrejt me objektin, vëllimin, kompleksitetin dhe afatin e realizimit të shërbimeve dhe të jetë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke respektuar parimet e konkurrencës efektive, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10 të Dokumenteve Standarde të Tenderit;
- b) Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3 të Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Argumentimi

Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të neneve 76, 82 dhe 83 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe të neneve 26 dhe 30 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Këto kërkesa janë hartuar në përputhje me Dokumentet Standarde të Tenderit në fuqi për procedurën e hapur për kontratat e shërbimeve.

Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit paraqitet nga operatori ekonomik si provë paraprake për të deklaruar se nuk ndodhet në kushtet e përjashtimit të parashikuara nga legjislacioni për prokurimin publik dhe se përmbush kriteret e kualifikimit të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Përdorimi i Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit lehtëson pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurë, duke shmangur kërkimin, në fazën e paraqitjes së ofertave, të të gjithë dokumentacionit provues për deklarimet e bëra në formular.

Dokumentacioni provues për vërtetimin e deklarimeve të bëra në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit paraqitet nga operatori ekonomik i renditur i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose kur kërkohet nga Autoriteti Kontraktor gjatë zhvillimit të procedurës, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi.

Kërkesa për paraqitjen e Sigurimit të Ofertës është vendosur për të garantuar seriozitetin dhe vlefshmërinë e ofertës, si dhe përmbushjen nga ofertuesi të detyrimeve që rrjedhin nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit.

Sigurimi i Ofertës duhet të paraqitet sipas formatit të Shtojcës 3 të Dokumenteve Standarde të Tenderit dhe në vlerën, formën dhe afatin e vlefshmërisë të përcaktuar në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, në përputhje me nenin 83 të ligjit nr. 162/2020 dhe nenin 30 të VKM-së nr. 285/2021, të ndryshuar.

Kërkesat e mësipërme burojnë drejtpërdrejt nga legjislacioni dhe Dokumentet Standarde të Tenderit, zbatohen në mënyrë të njëjtë për të gjithë ofertuesit dhe nuk vendosin kushte shtesë që mund të kufizojnë në mënyrë të pajustificuar pjesëmarrjen ose konkurrencën.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë

Operatori ekonomik duhet të paraqesë Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10 të Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Argumentimi

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 1, shkronja “a”, dhe pika 2, si dhe nenit 82 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në lidhje me nenin 26 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Kriteri është hartuar në përputhje me Dokumentet Standarde të Tenderit në fuqi për procedurën e hapur për kontratat e shërbimeve.

Nëpërmjet këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor synon të verifikojë përshtatshmërinë profesionale të operatorit ekonomik dhe ushtrimin në mënyrë të ligjshme të veprimtarisë së tij, sipas legjislacionit të shtetit ku është themeluar.

Për operatorët ekonomikë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, të dhënat e regjistrimit dhe statusi i tyre verifikohen nëpërmjet regjistrave dhe sistemeve elektronike shtetërore përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi. Për operatorët ekonomikë të huaj, pranohen dokumentet ekuivalente të lëshuara nga autoritetet kompetente të shtetit ku janë themeluar, sipas përcaktimeve të legjislacionit dhe Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Autoriteti Kontraktor nuk kërkon që objekti i veprimtarisë së operatorit ekonomik të jetë formuluar në mënyrë identike me emërtimin e objektit të procedurës së prokurimit. Vlerësimi bëhet mbi bazën e përshtatshmërisë profesionale dhe të së drejtës së operatorit ekonomik për të

ushtruar ligjërisht veprimtarinë përkatëse, pa vendosur kërkesa formale që kufizojnë në mënyrë të pajustificuar pjesëmarrjen.

Në zbatim të nenit 82 të ligjit nr. 162/2020 dhe nenit 26 të VKM-së nr. 285/2021, përmbushja paraprake e këtij kriteri deklarohet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues paraqitet nga operatori ekonomik i renditur i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose kur kërkohet nga Autoriteti Kontraktor gjatë zhvillimit të procedurës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Kërkesa zbatohet në mënyrë të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë dhe nuk vendos kushte formale ose kërkesa shtesë që kufizojnë në mënyrë të pajustificuar konkurrencën.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar

2.2.1 Për të provuar kapacitetin ekonomik dhe financiar, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokument të lëshuar ose të konfirmuar nga administrata tatimore, i cili vërteton xhiron vjetore të realizuar gjatë viteve financiare 2023, 2024 dhe 2025.

Vlera e xhiros vjetore të realizuar në të paktën një nga vitet financiare të kërkuara duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit, përkatësisht **5 345 643,09 (pesë milionë e treqind e dyzet e pesë mijë e gjashtëqind e dyzet e tre presje zero nëntë) lekë.**

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën minimale të xhiros në të paktën një nga vitet financiare të kërkuara.

Për operatorët ekonomikë që e kanë filluar veprimtarinë më pak se tre vjet përpara datës së publikimit të njoftimit të kontratës, kërkesa për xhiron vjetore vlerësohet në përputhje me periudhën gjatë së cilës operatori ekonomik ka ushtruar veprimtarinë dhe me përcaktimet e legjislacionit dhe Dokumenteve Standarde të Tenderit në fuqi.

Argumentimi

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 3, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 43, pikat 1, 2, shkronja “b”, dhe 3, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Nëpërmjet këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor synon të verifikojë se operatori ekonomik disponon kapacitetin ekonomik dhe financiar të nevojshëm për të përballuar detyrimet që lidhen me realizimin e kontratës.

Vlera e përlllogaritur e kontratës ndodhet ndërmjet kufirit të ulët dhe kufirit të lartë monetar për kontratat e shërbimeve. Në përputhje me nenin 43, pika 2, shkronja “b”, të VKM-së nr. 285/2021, të ndryshuar, vlera minimale e xhiros vjetore të kërkuar për këtë kategori procedure nuk duhet të tejkalojë vlerën e përlllogaritur të kontratës.

Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar vlerën minimale të xhiros vjetore në masën 40% të fondit limit. Mbi fondin limit prej 13 364 107,73 lekësh pa TVSH, kjo masë është:

13 364 107,73 lekë × 40% = 5 345 643,09 lekë.

Masa prej 40% është më e ulët se kufiri maksimal i lejuar dhe është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës, afatin katërmujor të realizimit, shumëllojshmërinë e ndërhyrjeve të parashikuara në preventiv dhe nevojën për sigurimin në kohë të personelit, materialeve, mjeteve dhe pajisjeve të nevojshme.

Grafiku i realizimit përfshin procese të ndryshme mirëmbajtjeje, të cilat mund të zhvillohen në mënyrë të koordinuar ose paralele gjatë periudhës së zbatimit. Për këtë arsye, operatori ekonomik duhet të ketë një nivel minimal të aktivitetit ekonomik që tregon aftësinë e tij për të përballuar angazhimet financiare dhe operative të kontratës, pa kërkuar një nivel xhiroje të barabartë me fondin limit.

Përcaktimi i viteve financiare 2023, 2024 dhe 2025 përfshin tri vitet financiare që i paraprijnë vitit të zhvillimit të procedurës. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën minimale të kërkuar në të paktën një nga këto vite, në përputhje me nenin 43, pika 3, të VKM-së nr. 285/2021, të ndryshuar.

Për operatorët ekonomikë që e kanë filluar veprimtarinë më pak se tre vjet përpara datës së publikimit të njoftimit të kontratës, vlerësimi bëhet mbi bazën e dokumentacionit të disponueshëm për periudhën faktike të ushtrimit të veprimtarisë, sipas legjislacionit dhe Dokumenteve Standarde të Tenderit në fuqi.

Kërkesa është e matshme, zbatohet në mënyrë të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë dhe është në përpjesëtim me vlerën, natyrën dhe afatin e kontratës. Ajo nuk kërkon xhiro të barabartë me fondin limit dhe nuk krijon kufizime të pajustificuara për konkurrencën.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin ose vërtetimet e lëshuara nga njësitë përkatëse të vetëqeverisjes vendore, që provojnë se operatori ekonomik nuk ka detyrime të maturuara dhe të pashlyera për taksat dhe tarifat vendore deri në datën e hapjes së ofertave.

Kërkesa zbatohet për njësitë e vetëqeverisjes vendore ku operatori ekonomik ka selinë ose vende aktive të ushtrimit të aktivitetit, sipas të dhënave të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Argumentimi

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 3, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 43, pika 6, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Kërkesa synon të verifikojë përmbushjen nga operatori ekonomik të detyrimeve të maturuara për taksat dhe tarifat vendore. Për efekt të kriterit merren në konsideratë vetëm detyrimet ose kështet, afati i pagesës së të cilave ka përfunduar deri në datën e hapjes së ofertave, sipas përcaktimeve të njësisë përkatëse të vetëqeverisjes vendore.

Kriteri zbatohet në mënyrë të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë dhe nuk përfshin detyrime të pamaturuara ose detyrime që lidhen me vende të mbyllura të ushtrimit të aktivitetit.

2.3 Kapaciteti teknik

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbime të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës.

Vlera e përgjithshme e shërbimeve të ngjashme të realizuara duhet të jetë jo më e vogël se 20% e fondit limit, përkatësisht **2 672 821,55 (dy milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e tetëqind e njëzet e një presje pesëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.**

Për efekt të këtij kriteri, konsiderohen të ngjashme shërbimet e mirëmbajtjes, riparimit ose riaftësimi të ndërtesave dhe objekteve civile, të cilat përfshijnë procese të së njëjtës natyre ose të krahasueshme me proceset e parashikuara në objektin e prokurimit. Nuk kërkohet që kontrata e mëparshme të ketë emërtim identik ose të përmbajë të gjitha proceset e kësaj kontrate.

Për të provuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

a) **Për kontratat e realizuara me sektorin publik:**

- vërtetim të lëshuar nga enti publik, ku të pasqyrohen objekti, vlera, perioda dhe realizimi me sukses i kontratës; **dhe**
- faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të identifikohen datat, vlerat dhe shërbimet e realizuara.

b) **Për kontratat e realizuara me sektorin privat:**

- faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të identifikohen datat, vlerat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 41, pikat 2 dhe 3, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, përfshirë ndryshimin e bërë me nenin 18 të VKM-së nr. 498, datë 01.08.2024.

Kërkesa synon të verifikojë se operatori ekonomik disponon përvojën teknike dhe profesionale të nevojshme për realizimin me sukses të kontratës. Përvoja kërkohet në mirëmbajtjen, riparimin ose riaftësimin e ndërtesave dhe objekteve civile, pasi preventivi përfshin ndërhyrje ndërtimore, elektrike, hidrosanitare, metalike dhe rifiniture në objekte ekzistuese.

Vlera minimale është përcaktuar në masën 20% të fondit limit:

13 364 107,73 lekë × 20% = 2 672 821,55 lekë.

Kjo vlerë është më e ulët se kufiri maksimal i lejuar për kontratat e shërbimeve dhe vlerësohet e mjaftueshme për të provuar përvojën reale të operatorit, pa kufizuar në mënyrë të pajustificuar konkurrencën.

Për kontratat e realizuara me sektorin publik kërkohen bashkërisht vërtetimi i lëshuar nga enti publik dhe faturat tatimore të shitjes. Vërtetimi provon realizimin me sukses të kontratës, ndërsa faturat e deklaruara në organet tatimore mundësojnë verifikimin e vlerës së shërbimeve të realizuara. Për kontratat me sektorin privat, përvoja provohet me faturat tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, sipas përcaktimeve të nenit 41, pika 3, të VKM-së nr. 285/2021, të ndryshuar.

Mundësia e përmbushjes së kriterit me një ose disa kontrata dhe moskërkimi i një objekti me emërtim identik mundësojnë pjesëmarrjen e operatorëve që kanë realizuar shërbime të krahasueshme për nga natyra.

Kërkesa është e matshme, lidhet drejtpërdrejt me natyrën dhe vlerën e kontratës dhe respekton parimet e proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe konkurrencës efektive.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë licencë profesionale të vlefshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit, të lëshuar nga autoriteti kompetent sipas VKM-së nr. 42, datë 16.01.2008, të ndryshuar, e cila duhet të përfshijë minimalisht kategoritë dhe nivelet e mëposhtme:

- **N.P-3, niveli A** – Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash;
- **N.P-1, niveli A** – Punime gjurmimi në tokë;
- **N.S-2, niveli A** – Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanderi dhe mirëmbajtja e tyre;

- **N.S-4, niveli A** – Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifinitura me materiale druri, plastike, metalike e xhami dhe rifinitura të natyrës teknike ndërtuese;
- **N.S-8, niveli A** – Ndërtime parafabrikate me beton të armuar, struktura metalike dhe druri;
- **N.S-14, niveli A** – Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni, TV etj.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar duhet të disponojë kategoritë e licencës që mbulojnë pjesën e kontratës që ka marrë përsipër të realizojë sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

Argumentimi

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe të nenit 41, pikat 2 dhe 4, shkronja “a”, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Kërkesa mbështetet gjithashtu në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, si dhe në VKM-në nr. 42, datë 16.01.2008, të ndryshuar, përfshirë ndryshimet e miratuara me VKM-në nr. 370, datë 02.07.2025.

Megjithëse kontrata klasifikohet si kontratë shërbimi, realizimi i saj përfshin procese ndërtimore, hidrosanitare dhe elektrike, për të cilat kërkohet që operatori të disponojë licencimin profesional përkatës. Kategoritë e kërkuara janë përcaktuar sipas proceseve konkrete të preventivit, si më poshtë:

Kategoria	Lidhja me preventivin	Niveli
N.P-3	Mirëmbajtja dhe riaftësimi i godinave, fasadave, çative, muraturës dhe elementeve të tyre	A
N.P-1	Zëri 2.29 – gërmim mekanik dheu për themele dhe plinta, në sasinë 186,6 m ³	
N.S-2	Zërat An.H01–An.H11 dhe zërat e tjerë për tubacionet, shkarkimet, pajisjet hidrosanitare, bolierët dhe kolektorët	A
N.S-4	Punimet e gipsit, suvatimit, hidroizolimit, dyerve, dritareve, pllakave, bojatisjes dhe rifiniturave të tjera	A
N.S-8	Zëri 4.300 – 2,5 tonë konstruksione metalike; rrethimi me rrjetë, portat dhe elementet metalike të fushave sportive	
N.S-14	Ndriçuesit, përcjellësit, tubat mbrojtës, çelësat, prizat, shtyllat e ndriçimit, prozhektorët, kuadrot dhe kabllot elektrike	A

Niveli A është kërkuar si niveli minimal i klasifikimit. Sipas kufijve të klasifikimit të parashikuar në rregulloren përkatëse, ky nivel mbulon vlera punimesh deri në 20 milionë lekë për kategori. Duke qenë se fondi limit i të gjithë kontratës është 13 364 107,73 lekë pa TVSH, vlera e zërave që i përkasin secilës kategori nuk mund ta tejkalojë këtë kufi. Për rrjedhojë, niveli A është i mjaftueshëm dhe proporcional.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, lidhja e licencave me pjesët e marra përsipër siguron që çdo proces të realizohet nga anëtari që disponon kategorinë përkatëse, pa kërkuar që çdo anëtar të zotërojë të gjitha kategoritë.

Kriteri lidhet drejtpërdrejt me proceset e preventivit dhe përfaqëson nivelin minimal të nevojshëm për realizimin e ligjshëm dhe teknikisht të rregullt të kontratës.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë personelin kryesor inxhinierik të mëposhtëm:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi;
- 1 (një) Inxhinier Elektrik;
- 1 (një) Inxhinier Mekanik.

Inxhinieri i Ndërtimit duhet të jetë i punësuar pranë operatorit ekonomik, të figurojë në listëpagesën e sigurimeve shoqërore për muajin e fundit të deklaruar në datën e publikimit të njoftimit të kontratës dhe të jetë drejtues teknik në licencën profesionale të operatorit ekonomik për kategoritë përkatëse.

Inxhinieri Elektrik dhe Inxhinieri Mekanik duhet të jenë të punësuar ose të angazhuar nëpërmjet një forme tjetër të ligjshme dhe të jenë të disponueshëm gjatë realizimit të proceseve përkatëse të kontratës.

Kriteri konsiderohet i përmbushur paraprakisht nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10 të Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Operatori ekonomik i renditur i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose kur kërkohet nga Autoriteti Kontraktor, duhet të paraqesë:

- diplomën përkatëse për secilin inxhinier;
- kontratën individuale të punës ose dokumentin tjetër të angazhimit ligjor;
- dokumentacionin e listëpagesës për personelin e punësuar;
- deklaratën individuale të disponueshmërisë për personelin e angazhuar jashtë marrëdhënies së punës;
- dokumentacionin që provon përfshirjen e Inxhinierit të Ndërtimit si drejtues teknik në licencën profesionale të operatorit ekonomik.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, personeli mund të sigurohet bashkërisht nga anëtarët e bashkimit, në përputhje me pjesët e kontratës që secili anëtar ka marrë përsipër të realizojë.

Argumentimi

Kriteri është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4, dhe nenit 82 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe të neneve 26 dhe 41, pikat 2 dhe 4, shkronja “b”, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Kërkesa lidhet gjithashtu me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, dhe me VKM-në nr. 42, datë 16.01.2008, të ndryshuar, përfshirë ndryshimet e miratuara me VKM-në nr. 370, datë 02.07.2025.

Profilet janë përcaktuar sipas proceseve të preventivit. Inxhinieri i Ndërtimit kërkohet për drejtimin dhe koordinimin teknik të proceseve civile, përfshirë gërmimet, betonin dhe armaturën, muraturën, çatinë, shtresat, rifiniturat dhe konstruksionet metalike. Inxhinieri Elektrik kërkohet për instalimet e ndriçimit, përcjellësit, kabllot, çelësat, prizat, kuadrot dhe pajisjet elektrike. Inxhinieri Mekanik kërkohet për instalimet hidrosanitare, tubacionet e furnizimit dhe shkarkimit, pajisjet sanitare, bolierët dhe kolektorët.

Kërkesa që Inxhinieri i Ndërtimit të jetë drejtues teknik në licencën profesionale lidhet me kategoritë e licencës të kërkuara për proceset kryesore ndërtimore. Për Inxhinierin Elektrik dhe Inxhinierin Mekanik pranohet punësimi ose një formë tjetër e ligjshme angazhimi, me qëllim sigurimin e disponueshmërisë së tyre pa kufizuar në mënyrë të pajustificuar konkurrencën.

Numri dhe profilet e kërkuara përfaqësojnë minimumin e nevojshëm për mbulimin teknik të proceseve civile, elektrike dhe hidrosanitare të kontratës dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe kompleksitetin e saj.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë jo më pak se 14 (katërmëdhjetë) punonjës të siguruar, për muajin e fundit të deklaruar në datën e publikimit të njoftimit të kontratës, si dhe 1 (një) manovrator, sipas profileve të mëposhtme:

Nr.	Profili	Numri minimal
1	Punëtor i pakualifikuar	1
2	Marangoz	1
3	Pllakashtrues	1
4	Punëtor ndërtimi	1
5	Bojaxhi	2
6	Punëtor/mjeshtër gipsi	1
7	Mjeshtër çatie	2
8	Elektrici	1
9	Hidraulik	1
10	Mjeshtër betoni	2
11	Saldator	1
	Gjithsej punonjës të siguruar	14
12	Manovrator, i punësuar ose i siguruar ligjërisht bashkë me makinerinë	1

Gjithsej: 14 punonjës të siguruar dhe 1 manovrator.

Personeli inxhinierik i kërkuar në pikën 2.3.3 nuk përfshihet në numrin prej 14 punonjësish të përcaktuar në këtë kriter.

Kriteri konsiderohet i përmbushur paraprakisht nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10 të Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Operatori ekonomik i renditur i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose kur kërkohet nga Autoriteti Kontraktor, duhet të paraqesë:

a) Për 14 punonjësit e siguruar:

- kontratën individuale të punës;
- dokumentacionin që provon regjistrimin në listëpagesën e sigurimeve shoqërore për muajin e fundit të deklaruar në datën e publikimit të njoftimit të kontratës.

b) Për personelin e kualifikuar:

Për marangozin, pllakashtruesin, bojaxhinjtë, punëtorin/mjeshterin e gipsit, mjeshtrit e çatisë, elektrikistin, hidraulikun, mjeshtrit e betonit dhe saldatorin duhet të paraqitet diplomë, certifikatë, dëshmi kualifikimi profesional ose dokument tjetër i barasvlershëm, i lëshuar nga një institucion arsimor, ofrues i formimit profesional ose institucion tjetër i autorizuar sipas legjislacionit në fuqi.

Për profesionet për të cilat legjislacioni i posaçëm kërkon dëshmi aftësie, certifikim ose autorizim të detyrueshëm, dokumenti përkatës duhet të jetë i vlefshëm në datën e hapjes së ofertave.

c) Për manovratorin:

Kur manovratori është i punësuar pranë operatorit ekonomik, duhet të paraqiten:

- kontrata individuale e punës;
- dokumentacioni i listëpagesës për muajin e fundit të deklaruar;
- leja, dëshmia e aftësisë ose dokumenti tjetër i vlefshëm për drejtimin e makinerisë përkatëse.

Kur manovratori sigurohet bashkë me makinerinë, duhet të paraqiten:

- kontrata e qirasë, shërbimit ose dokumenti tjetër që provon angazhimin e ligjshëm të tij për periudhën përkatëse të realizimit të kontratës;
- leja, dëshmia e aftësisë ose dokumenti tjetër i vlefshëm për drejtimin e makinerisë përkatëse.

Dokumenti i kualifikimit të manovratorit duhet të përputhet me llojin e makinerisë për të cilën deklarohet.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, numri dhe profilet e personelit mund të plotësohen bashkërisht nga anëtarët, në përputhje me pjesët e kontratës që secili ka marrë përsipër sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

Argumentimi

Kriteri është përcaktuar në mbështetje të neneve 77, pika 4, dhe 82 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe të neneve 26 dhe 41, pikat 2 dhe 4, shkronjat “b” dhe “c”, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Numri dhe profilet e personelit janë përcaktuar sipas preventivit, specifikimeve teknike dhe afatit katërmujor të realizimit. Bojaxhinjtë lidhen me rreth 3 423 m² punime bojatisjeje; mjeshtrit e çatisë me rreth 560 m² ndërhyrje në çati; mjeshtrit e betonit me proceset e betonit dhe betonarmesë; saldatori me 2,5 tonë konstruksione metalike, rrethimet dhe portat; ndërsa profilet e tjera lidhen me punimet e gipsit, pllakave, drurit, instalimeve elektrike dhe hidrosanitare të parashikuara në preventiv.

Manovratori kërkohet për përdorimin e ekskavatorit dhe makinerive përkatëse. Meqenëse makineria mund të sigurohet me qira ose nëpërmjet një forme tjetër të ligjshme, nuk kërkohet domosdoshmërisht që manovratori të jetë në listëpagesën e operatorit ekonomik. Ai mund të sigurohet bashkë me makinerinë, me kusht që të provohen angazhimi i ligjshëm dhe kualifikimi përkatës.

Kërkesa për dokumentet e kualifikimit synon që proceset e specializuara të realizohen nga persona me aftësitë përkatëse. Pranimi i diplomës, certifikatës, dëshmisë profesionale ose dokumentit të barasvlershëm shmanë kufizimin e provueshmërisë në një formë të vetme.

Kriteri lidhet gjithashtu me ligjin nr. 10237, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, të ndryshuar, dhe me VKM-në nr. 312, datë 05.05.2010, “Për miratimin e Rregullores ‘Për sigurinë në kantier’”, të ndryshuar.

Numri dhe profilet e kërkuara përfaqësojnë kapacitetin minimal për realizimin e proceseve të preventivit brenda afatit kontraktor dhe janë në përpjesëtim me natyrën, vëllimin dhe kompleksitetin e kontratës.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë, në pronësi, me qira, huapërdorje ose nëpërmjet një forme tjetër të ligjshme përdorimi, minimalisht nga 1 (një) njësi për secilin mjet/pajisje:

Nr.	Mjeti/pajisja	Sasia
1	Ekskavator me kapacitet të kovës jo më të vogël se 0,5 m³	1
2	Grejder	1
3	Trapano elektrike	1
4	Vibrator betoni	1
5	Aparat elektrosaldimi	1
6	Pajisje prerjeje dhe saldimi me oksigjen-gaz	1
7	Autovinç	1
8	Vinç kullë me kapacitet ngritës jo më të vogël se 4 tonë	1
9	Pompë suvatimi	1

Mjetet dhe pajisjet duhet të jenë të disponueshme gjatë periudhës kur përdorimi i tyre kërkohet sipas grafikut të realizimit të kontratës.

Për mjetet që kërkojnë personel të kualifikuar, operatori ekonomik duhet të disponojë personel me lejen, dëshminë e aftësisë ose dokumentin përkatës.

Kriteri konsiderohet i përmbushur paraprakisht nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10 të Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Operatori ekonomik i renditur i pari, ose kur kërkohet nga Autoriteti Kontraktor, duhet të paraqesë:

- për mjetet e regjistruara: dokumentet e regjistrimit, kontrollit teknik, sigurimit dhe kontrollit të pajisjes ngritëse, kur kërkohen nga legjislacioni;
- për pajisjet e paregjistruara në pronësi: faturë blerjeje, dokument doganor, regjistër aktivesh të shoqëruar me dokumentin mbështetës ose dokument tjetër që provon pronësinë;
- për mjetet ose pajisjet e siguruar nga të tretët: kontratën që provon të drejtën e përdorimit, dokumentacionin e pronësisë së dhënësit dhe dokumentet teknike përkatëse.

Dokumentet me afat vlefshmërie duhet të jenë të vlefshme në datën e hapjes së ofertave. Kontrata e përdorimit duhet të mbulojë periudhën kur mjeti ose pajisja kërkohet për realizimin e kontratës.

Në rast bashkimi operatorësh, mjetet dhe pajisjet mund të sigurohen bashkërisht, sipas pjesëve të kontratës që secili anëtar ka marrë përsipër.

Argumentimi

Kriteri është përcaktuar në mbështetje të neneve 77, pika 4, dhe 82 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe të neneve 26 dhe 41, pikat 2 dhe 4, shkronja “ç”, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Mjetet dhe pajisjet janë përcaktuar nga njësia teknike mbi bazën e preventivit, specifikimeve teknike, mënyrës teknologjike të realizimit dhe afatit katërmujor të kontratës. Konkretisht:

- ekskavatori me kovë minimumi 0,5 m³ lidhet me zërin 2.29 për 186,6 m³ gërmim mekanik;
- grejderi lidhet me nivelimin dhe profilimin e 622 m² shtresë zhavorri;
- trapanoja kërkohet për shpimin dhe montimin e pajisjeve dhe instalimeve;
- vibratori kërkohet për realizimin e themeleve, shtresave, plintave dhe bazamenteve prej betoni;
- pajisjet e saldimit dhe prerjes kërkohen për 2,5 tonë konstruksione metalike, 513 m² rrethim, portat dhe elementet e tjera metalike;
- autovinçi kërkohet për ngarkimin, shkarkimin dhe pozicionimin e shtyllave të ndriçimit me lartësi 7 m dhe të elementeve metalike në objekte të ndryshme;
- vinçi kullë kërkohet për ngritjen dhe montimin në lartësi ose në distancë të elementeve që, sipas analizës së njësisë teknike, kërkojnë përdorimin e një pajisjeje ngritëse stacionare;
- pompa e suvatimit lidhet me zërin 2.310/1 për 524 m² suvatim mekanik me pompë.

Autovinçi dhe vinçi kullë kryejnë funksione të ndryshme. Autovinçi përdoret për ngarkim, shkarkim dhe pozicionim në objekte të ndryshme, ndërsa vinçi kullë përdoret për ngritjen stacionare në lartësi ose në distancë. Kapaciteti minimal prej 4 tonësh është përcaktuar nga njësia teknike për ngritjen stacionare të elementeve në lartësi ose në distancë. Relacioni teknik i njësisë kërkuese, ku identifikohen elementet, pesha, lartësia dhe rrezja e nevojshme e punës, duhet të administrohet në dosjen e procedurës përpara publikimit.

Pranimi i pronësisë, qirasë, huapërdorjes ose një forme tjetër të ligjshme përdorimi shmang kufizimin e pjesëmarrjes vetëm tek operatorët që i zotërojnë mjetet në pronësi.

Kërkesa lidhet me proceset e preventivit dhe përfaqëson kapacitetin teknik minimal të nevojshëm për realizimin e kontratës brenda afatit të përcaktuar.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë certifikatat e mëposhtme, të vlefshme në datën e hapjes së ofertave:

1. **SSH EN ISO 9001:2015 (ISO 9001:2015)** ose standard ekuivalent – Sistemet e menaxhimit të cilësisë;
2. **SSH EN ISO 14001:2015 (ISO 14001:2015)** ose standard ekuivalent – Sistemet e menaxhimit të mjedisit;
3. **SSH ISO 45001:2018 ose SSH EN ISO 45001:2023** ose standard ekuivalent – Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë;
4. **SSH EN ISO 3834-2:2021 (ISO 3834-2:2021)** ose standard ekuivalent – Kërkesa të plota të cilësisë për saldimin me shkrirje të materialeve metalike.

Certifikatat duhet të jenë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Fusha e certifikimit duhet të lidhet me shërbimet dhe proceset përkatëse të objektit të prokurimit. Për certifikatën ISO 3834-2:2021, fusha duhet të përfshijë prodhimin, montimin ose saldimin e konstruksioneve dhe elementeve metalike.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, certifikatat duhet të disponohen nga anëtari ose anëtarët që marrin përsipër shërbimet dhe proceset me të cilat lidhet certifikimi përkatës.

Argumentimi

Kriteri është përcaktuar në mbështetje të nenit 79 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të nenit 44 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Kërkesa për certifikatën **ISO 9001:2015** synon të verifikojë se operatori ekonomik zbaton një sistem të dokumentuar të menaxhimit dhe kontrollit të cilësisë. Ky sistem është i nevojshëm për organizimin, koordinimin dhe kontrollin e proceseve të ndryshme të kontratës, verifikimin e përputhshmërisë së materialeve dhe trajtimin e mangësive gjatë zbatimit.

Kërkesa për certifikatën **ISO 14001:2015** lidhet me ndikimet mjedisore që mund të krijohen gjatë realizimit të kontratës, përfshirë mbetjet nga prishjet dhe zëvendësimet, pluhurin, zhurmën, përdorimin dhe magazinimin e materialeve, si dhe pastrimin e zonave ku kryhen ndërhyrjet. Menaxhimi i këtyre ndikimeve është veçanërisht i rëndësishëm për shkak se shërbimet realizohen në objekte të arsimit bazë.

Kërkesa për certifikatën **ISO 45001:2018** lidhet me menaxhimin e rreziqeve për shëndetin dhe sigurinë në punë gjatë gërmimeve, ndërhyrjeve elektrike dhe hidrosanitare, punimeve në lartësi dhe në çati, realizimit të elementeve prej betoni, përdorimit të makinerive dhe pajisjeve ngritëse, si dhe prerjes dhe saldimit të elementeve metalike.

Kërkesa për certifikatën **ISO 3834-2:2021** lidhet me proceset e saldimit të parashikuara në preventiv, veçanërisht me zërin 4.300 për 2,5 tonë konstruksione metalike të thjeshta, 513 m² rrethim me rrjetë, portat dhe elementet metalike të fushave sportive. Standardi synon kontrollin e materialeve, personelit, pajisjeve, procedurave dhe inspektimit të proceseve të saldimit, me qëllim shmangien e defekteve në bashkimet metalike.

Kërkesa që fusha e certifikimit të lidhet me veprimtarinë përkatëse siguron që certifikatat të jenë relevante për proceset e kontratës. Pranimi i standardeve dhe provave ekuivalente, si dhe shpërndarja e certifikatave ndërmjet anëtarëve të bashkimit sipas pjesëve të marra përsipër, shmangin kufizimin e pajustificuar të pjesëmarrjes.

Certifikatat e kërkuara lidhen drejtpërdrejt me rreziqet dhe proceset konkrete të kontratës dhe synojnë realizimin e saj sipas kërkesave të cilësisë, mbrojtjes së mjedisit dhe sigurisë në punë. Kriteri është në përpjesëtim me natyrën dhe kompleksitetin e objektit të prokurimit dhe nuk krijon kufizime të pajustificuara për konkurrencën.

2.3.7 Për materialet kryesore të mëposhtme, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion që provon burimin e ligjshëm të furnizimit dhe përputhshmërinë e tyre me specifikimet teknike:

Nr.	Materiali
1	Pllaka gipsi rezistente ndaj lagështirës dhe profilet përkatëse
2	Dyer të brendshme tamburate të rimesuara
3	Dyer dhe dritare duralumini
4	Ndriçues plafonierë
5	Përcjellës bakri
6	Shtylla metalike për ndriçim
7	Puseta plastike 40 × 40 × 40 cm me kapak
8	Prozhektorë LED
9	Kuadër komandimi për ndriçim
10	Tuba dhe rakorderi multistrato PEX
11	Tuba dhe rakorderi shkarkimi prej polipropileni
12	Lavamanë porcelani
13	Pajisje WC
14	Bolierë
15	Kolektorë për lidhjen e tubave multistrato
16	Kollë, rrjetë dhe stuko rezistente ndaj zjarrit për suvatime dhe patinime të brendshme
17	Pllaka gres
18	Pllaka mermeri
19	Bojë hidroplastike

Për të provuar burimin e furnizimit, operatori ekonomik duhet të paraqesë një nga dokumentet e mëposhtme:

- autorizim nga prodhuesi;
- autorizim nga distributori i autorizuar, i shoqëruar me dokumentin që provon marrëdhënien e distributorit me prodhuesin;
- kontratë furnizimi, marrëveshje paraprake furnizimi, ofertë furnizimi ose dokument tjetër të ligjshëm që provon mundësinë e sigurimit të materialeve për realizimin e kontratës.

Dokumentacioni duhet të mundësojë identifikimin e prodhuesit ose furnizuesit, operatorit ekonomik, materialit përkatës dhe procedurës së prokurimit.

Për të provuar përputhshmërinë me specifikimet teknike, duhet të paraqiten, sipas natyrës së produktit:

- katalogë ose skeda teknike të prodhuesit;
- deklarata performance;
- deklarata konformiteti;
- dokumentacion për markimin CE;
- certifikata, raporte prove ose dokumente të tjera ekuivalente të parashikuara nga legjislacioni për produktin përkatës.

Markimi CE dhe dokumentacioni përkatës kërkohen vetëm për produktet për të cilat janë të zbatueshme sipas legjislacionit në fuqi. Për produktet për të cilat markimi CE nuk është i

detyrueshëm, pranohen dokumente të tjera që provojnë përputhshmërinë me specifikimet teknike dhe standardet e zbatueshme.

Në të gjitha rastet pranohen produkte, standarde dhe dokumente ekuivalente, me kusht që operatori ekonomik të provojë se materiali i propozuar përmbush kërkesat teknike dhe funksionale të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, dokumentacioni mund të paraqitet nga anëtarë që ka marrë përsipër furnizimin ose përdorimin e materialeve përkatëse.

Argumentimi

Kriteri është përcaktuar në mbështetje të nenit 36 dhe nenit 77, pika 4, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe të nenit 41, pika 6, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Materialet e listuara përbëjnë elemente që do të përdoren në instalimet, rifiniturat dhe ndërhyrjet e parashikuara në preventiv. Cilësia dhe karakteristikat e tyre ndikojnë drejtpërdrejt në funksionalitetin, sigurinë, qëndrueshmërinë dhe jetëgjatësinë e ndërhyrjeve të realizuara në objektet e arsimit bazë.

Dokumentacioni për burimin e furnizimit synon të provojë se operatori ekonomik ka mundësi reale dhe të ligjshme për sigurimin e materialeve të propozuara. Për të mos kufizuar pjesëmarrjen vetëm tek operatorët që kanë marrëdhënie të drejtpërdrejtë me prodhuesin, krahas autorizimit të prodhuesit ose distributorit të autorizuar, pranohen edhe kontrata, marrëveshje ose dokumente të tjera të ligjshme furnizimi.

Katalogët, skadat teknike, deklaratat e performancës, deklaratat e konformitetit, dokumentacioni i markimit CE dhe raportet e provave mundësojnë verifikimin e karakteristikave të materialeve kundrejt specifikimeve teknike. Lloji i dokumentit vlerësohet sipas natyrës së produktit dhe kërkesave ligjore të zbatueshme për të.

Pranimi i dokumenteve dhe produkteve ekuivalente siguron që kriteri të mos favorizojë një prodhues, distributor, markë ose zinxhir të caktuar furnizimi. Kërkesa lidhet me materialet e preventivit dhe synon realizimin e kontratës me materiale të përshtatshme, të sigurta dhe në përputhje me specifikimet teknike.

II. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet teknike dhe termat e referencës janë hartuar në mbështetje të nenit 36 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe të nenit 2, pika 2, shkronja “c”, nenit 41 dhe nenit 78 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Specifikimet teknike janë përgatitur nga njësia teknike, duke u bazuar në nevojat konkrete të Autoritetit Kontraktor, gjendjen ekzistuese të objekteve të arsimit bazë, preventivin, grafikun katërmujor të realizimit dhe natyrën e ndërhyrjeve të mirëmbajtjes që do të kryhen.

Qëllimi i tyre është përcaktimi i kërkesave minimale për materialet, pajisjet, mënyrën e realizimit, kontrollin e cilësisë dhe kushtet e sigurisë, me qëllim ruajtjen ose rikthimin e funksionalitetit, qëndrueshmërisë dhe sigurisë së objekteve arsimore ekzistuese.

Specifikimet teknike lidhen me proceset e parashikuara në preventiv, të cilat përfshijnë:

- prishje të pjesshme, pastrim dhe largim materialesh;
- gërmime, transport materialesh dhe shtresa zhavorri;

- punime gipsi dhe tavane të varura;
- riparim ose zëvendësim të dyerve dhe dritareve;
- instalime elektrike dhe ndriçimi;
- suvatime, patinime, hidroizolime dhe shtresa;
- instalime hidrosanitare dhe pajisje sanitare;
- punime betoni, betonarmeje dhe armature;
- shtrime me pllaka dhe mermer;
- bojatisje të sipërfaqeve;
- konstruksione, rrethime dhe elemente metalike;
- riparime dhe hidroizolime të çatave;
- punime murature.

Kërkesat për punimet e dheut lidhen, ndër të tjera, me zërin 2.29 për 186,6 m³ gjurmim mekanik dhe me 622 m² shtresë zhavorri. Kërkesat për betonin dhe armaturën lidhen me themelet, shtresat, plintat dhe bazamentet betonarme, si dhe me 6,6 tonë hekur periodik të parashikuar në preventiv.

Specifikimet për rifiniturat lidhen, ndër të tjera, me 524 m² suvatim të brendshëm mekanik, suvatimin e fasadave, patinimet, hidroizolimet dhe rreth 3 423 m² bojatisje. Specifikimet për çatitë lidhen me ndërhyrjet e parashikuara në rreth 560 m² sipërfaqe çatie.

Specifikimet hidrosanitare lidhen me tubacionet e furnizimit dhe shkarkimit, pajisjet sanitare, lavamanët, bolierët, kolektorët dhe elementet e tjera të parashikuara në preventiv. Specifikimet elektrike lidhen me ndriçuesit, përcjellësit, tubat mbrojtës, çelësat, prizat, shtyllat e ndriçimit, prozhektorët, kuadrot dhe kabllot elektrike.

Specifikimet për konstruksionet metalike lidhen me 2,5 tonë konstruksione metalike të thjeshta, 513 m² rrethim me rrjetë, portat dhe elementet metalike të fushave sportive. Ato përcaktojnë kërkesat për materialet, përpunimin, montimin, saldimin, lidhjet dhe mbrojtjen e elementeve metalike.

Përmbajtja e specifikimeve teknike zbatohet vetëm për proceset, materialet dhe pajisjet që përfshihen në preventiv dhe në dokumentet e tenderit. Pjesët e përgjithshme të dokumentit teknik që nuk lidhen me zëra konkretë të preventivit nuk krijojnë detyrime shtesë dhe nuk zgjerojnë objektin e kontratës.

Materialet dhe pajisjet që do të bëhen pjesë e objekteve pas realizimit të kontratës duhet të jenë të reja, të papërdorura, të përshtatshme për destinacionin e tyre dhe në përputhje me karakteristikat e përcaktuara në preventiv dhe specifikimet teknike.

Materialet dhe pajisjet duhet të plotësojnë standardet shqiptare në fuqi, standardet europiane të adoptuara ose standarde të tjera ekuivalente. Kur për produktin konkret legjislacioni parashikon deklaratë performance, deklaratë konformiteti, markim CE, raport prove, skedë teknike, certifikatë ose dokument tjetër shoqërues, duhet të paraqitet dokumentacioni përkatës, sipas kërkesave të dokumenteve të tenderit dhe legjislacionit në fuqi.

Shërbimet dhe ndërhyrjet duhet të realizohen në përputhje me:

- preventivin;
- specifikimet teknike dhe termat e referencës;
- grafikun e realizimit;

- kushtet teknike të zbatimit për proceset përkatëse;
- standardet shqiptare, standardet europiane të adoptuara ose standardet ekuivalente;
- udhëzimet teknike të prodhuesve të materialeve dhe pajisjeve;
- legjislacionin në fushën e ndërtimit;
- legjislacionin për sigurinë dhe shëndetin në punë;
- kërkesat për mbrojtjen nga zjarri, sigurinë elektrike dhe mbrojtjen e mjedisit.

Për shkak se ndërhyrjet do të realizohen në objekte të arsimit bazë, gjatë zbatimit të kontratës duhet të merren masa për kufizimin dhe sinjalizimin e zonave të punës, mbrojtjen e nxënësve dhe personelit, sigurimin e kalimeve, administrimin e mbetjeve dhe kufizimin e pluhurit, zhurmës dhe rreziqeve të tjera. Organizimi i ndërhyrjeve duhet të koordinohet me Autoritetin Kontraktor dhe drejtuesit e objekteve përkatëse, pa cenuar sigurinë dhe funksionimin e tyre.

Specifikimet teknike duhet të interpretohen dhe zbatohen duke respektuar parimin e ekuivalencës. Referencat ndaj standardeve, materialeve, metodave, tipeve ose karakteristikave të caktuara nuk duhet të interpretohen si kufizim ndaj një prodhuesi, marke, origjine ose burimi të veçantë.

Kur përdorimi i një reference specifike është i domosdoshëm për përshkrimin e qartë të kërkesës teknike, ajo duhet të shoqërohet me shprehjen “ose ekuivalent”, në përputhje me nenin 36 të ligjit nr. 162/2020, të ndryshuar.

Operatori ekonomik ka të drejtë të provojë, me çdo mjet të përshtatshëm dhe të pranueshëm sipas legjislacionit, se materiali, produkti, standardi ose zgjidhja teknike e propozuar përmbush në mënyrë ekuivalente kërkesat teknike dhe funksionale të Autoritetit Kontraktor.

Specifikimet teknike përfaqësojnë kërkesat minimale të nevojshme për realizimin cilësor dhe të sigurt të kontratës. Ato lidhen drejtpërdrejt me proceset dhe sasi të preventivit, janë në përpjesëtim me natyrën dhe vëllimin e ndërhyrjeve dhe nuk krijojnë pengesa të pajustificuara për konkurrencën.

Për sa më sipër, specifikimet teknike dhe termat e referencës vlerësohen të përshtatshme për realizimin e kontratës me objekt “Mirëmbajtje e zakonshme e objekteve të arsimit bazë” dhe janë hartuar duke respektuar parimet e transparencës, proporcionalitetit, trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit dhe konkurrencës efektive.